



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 37 Datë 28.04.2022

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	BASHKIA DIMAL
Hetim Administrativ, iniciuar nga	<ul style="list-style-type: none">• APP X• Reklamim nga të tretë
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë prokurimi "E hapur"
Konstatimet kryesore	<p>1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës) dhe nenin 61 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës), lidhur me hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta/ specifikimeve teknike, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ.</p> <p>2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës), lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ.</p>
Masat e marra	Në bazë të neneve 23, gërma "e", 130, 132, pikat 1/g/gj dhe 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj 4 personave, si dhe të dënojë me gjobë 4 persona, të evidentuar përgjegjës, sipas konstatimeve në këtë vendim.